



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:139662

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06750657

2023:139663

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani dhe praktikantën Diellza Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.H. me vendbanim në rrugën “...” në Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP/II.nr.610/21 e datës 22 Qershor 2023, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër:07/25 e datës 14 Janar 2025, në mes të pandehurit A.H., në njërën anë dhe të dëmtuarit A. D. në anën tjetër, në bazë të nenit 357 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së (Kodi me numnër 08/L-032), si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 23 Janar 2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

- **APROVOHET**, marrëveshja ndërmjetësimit me numër: 07/25 i datës 14 Janar 2025, në mes të pandehurit A.H., në njërën anë dhe të dëmtuarit A. D. në anën tjetër.
- **HUDHET**, Aktakuza Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.610/24 e datës 22 Qershor 2023 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit A.H., i lindur me datë, nga i ati I. e ëma S., me vendbanim në rrugën “...” në Ferizaj, me numër personal, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër kundër të pandehurit pandehurit A.H. me vendbanim në rrugën “.....” në, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP/II.nr.610/21 e datës 22 Qershor 2023, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 14 Janar 2025, në prezencën e prokurorit të shtetit, të dëmtuarit dhe të pandehurit.

Gjyqtarja, duke vepruar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë dhe në bazë të nenit 229 të KPP-ës dhe nenit 8 par.1 dhe par.2 dhe nenit 14 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që lënda penale të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim, me datën 14 Janar 2025, në mes palëve në procedurë respektivisht të pandehurit A.H. si dhe të dëmtuarit A. D..

Pala e dëmtuar deklaron se pajtohet që kjo lëndë të zgjidhet me procedurë të ndermetësimit, heq dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, pasi që pas këtij rasti më nuk kanë pasur probleme me të akuzuarin dhe se i njejti premtion që nuk do ta shqetësoj në të ardhmen.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, vlerëson se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje penale sipas aktakuzës së evidentuar si: PP.II.nr.610/23 e datës 22 Qershor 2023, për veprën penale që i ngarkon të pandehurit të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar

Në bazë të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, marrëveshja e ndërmjetësimit në datën e aprovimit nga gjykata përkatësisht nga data 23 Janar 2025, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPP-ës, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal,

2023:139663 e datës 23 Janar 2025

Praktikante,
Diellza Azemi

Gjyqtarja,
Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta e ankesës.